

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Vërtetësia¹ / es-Sidk / الصِّدْق

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"فَإِذَا عَزَمَ الْأَمْرُ فَلَوْ صَدَقُوا اللَّهَ لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ"

"Kur çështja që caktuar, do të ishte më mirë për ta sikur të ishin të vërtetë ndaj Allahut." (Muhamed, 21)²

Vërtetësia është një emër për realitetin e një gjëje / ngjarjeje të caktuar, për sa i përket ndodhjes apo ekzistimit të saj.³ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është vërtetësia e qëllimit, nëpërmjet së cilës verifikohet hyrja në këtë çështje, shmangjet shkujdesja, rifitohet shansi i humbur, dhe rehabilitohesh nga dëmtimi.⁴

Shenjat e personit të vërtetë janë:

1. Ai nuk toleron thirrjet për prishjen e marrëveshjes⁵ (që ka me Zotin)
2. Ai nuk tregohet i duruar me shoqërinë e kundërshtuesve.⁶

¹ Kuptime të tjera: ndershmëri, origjinalitet, sinqeritet, besueshmëri, çiltërsi.

² Fokusi këtu është te vërtetësia ndaj Allahut, që është lloji më i rëndësishëm i vërtetësisë dhe origjina e të gjitha vërtetësive të tjerave. Allahu po ashtu kërkon prej nesh të jemi të vërtetë ndaj vetëve tona dhe ndaj të tjerëve.

³ Vërtetësia ka të bëjë me harmoninë mes të folurës dhe realiteteve, mes fjalëve dhe veprimeve, mes të brendshmes dhe të jashtmes, mes pohimeve dhe provave (për ato pohime), etj.

⁴ Kur të arrihet dëlirësia e qëllimit dhe ti nuk gënjen veten në këtë, të gjitha gabimet mund të ndreqen.

⁵ Jo vetëm që s'do t'i përfillësh këto thirrje, por ato do të ngjallin neveri te ti.

⁶ Kundërshtarët e rrugës së Zotit do të ta ngjallin antipatinë aty për aty. Ti do të nuhatësh mungesën e sinqeritetit, mospërputhjen, arrogancën, paragjykimin,

3. Vendosmëria e tij nuk lëkundet.

Niveli i dytë:

- Të mos shpresosh jetë të gjatë, përveçse për të Vërtetin⁷
- Të mos shohësh në vetvete gjë tjetër veç gabimeve dhe mangësive
- T'i shmangesh përdorimit të lehtësimeve⁸

Niveli i tretë është vërtetësia në njohjen e vërtetësisë, meqë, sipas të kuptuarit të elitës së besimtarëve, vërtetësia nuk realizohet përveçse në një rast - atëherë kur ka harmoni mes kënaqësisë së Zotit dhe veprimeve të robit, gjendjes së tij, çasteve të tij, bindjes dhe qëllimit të tij.⁹ Në këtë mënyrë, robi bëhet i kënaqshëm (për Zotin e tij) dhe i kënaqur me Të. Veprimet e tij do të pranohen, gjendja e tij do të jetë e vërtetë, dhe qëllimet e tija do të jenë të drejta. Mirëpo, nëse robi vishet me tasha të huazuara,¹⁰ vepra e tij më e mirë do të jetë gjynahu, gjendja më e vërtetë e tij do të jetë pavërtetësia, dhe qëllimi më i mirë i tij do të jetë dembelia.

shkujdesjen, dhe të tjera vese në të folurën apo sjelljen e tyre. Përzierja me ta do të jetë vetëm për një të mirë të përbashkët, dhe për të mirën e tyre, nëse mund t'u ndihmohet të marrin veten nga sëmundja që kanë; apo për një interes të kësaj bote, aq sa ke nevojë të qëndrosh në shoqëri me ta.

⁷ Të vazhdosh të fitosh kënaqësinë e Tij.

⁸ Lëshimet të cilave do të mund t'u shmangeshe janë ato, që nuk janë të verifikuara apo dhe janë çështje të dyshimta. Në anën tjetër, lëshimet e porositura nga Allahu janë të dashura për Të.

⁹ I vetmi që mund të na udhëzojë drejt kënaqësisë së Allahut është pranuesi i shpalljes së Tij – i Dërguari Muhamed ﷺ.

¹⁰ Personi bart teshën që s'është e tij, kur flet, kur vepron; apo vishet si një i devotshëm, pa pasur zemrën e një të devotshmi apo qëllimet e tij.